REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE

Nr. 4814, Datë 29 . 12 . 2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE

Nr. 10892, Datë 29 . 12 . 2023

PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN
"PËR KRITERET, RREGULLAT DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË RAPORTEVE MJEKËSORE PËR PAAFTËSITË PËRKOHSHME PËR PUNË, PËR BARRËLINDJE DHE PËR AKSIDENTE NË PUNË E SËMUNDJE PROFESIONALE"

Në mbështetje të neneve 21, 22, 23, 27, 28, 47 dhe 75 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; Ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", i ndryshuar; Ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 13.9.2017 "Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 4.7.2018 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 503, datë 24.6.2020 "Për mënyrën e administrimit të informacionit elektronik shëndetësor"; Urdhrit nr. 493, datë 2.7.2019 "Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik", Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, miratojnë këto shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2666/1, datë 21.6.2022 / nr. 4360/1, datë 22.6.2022 "Për kriteret, rregullat dhe procedurat për lëshimin e raporteve mjekësore për paaftësi të përkohshme për punë, për barrëlindje dhe për aksidente në punë e sëmundje profesionale":

1. Në nenin 4 të Rregullores, pika 2, pas shkronjës "d", shtohet shkronja "dh", me këtë përmbajtje: "Raport për paaftësi të përkohshme në punë që lëshohet nga institucione shëndetësore me shtretër".

2. Pas pikës 2, të nenit 5, të Rregullores, shtohet pika "3", me këtë përmbajtje:

"3. Raporti elektronik mjekësor, i parashikuar në shkronjën "dh", të pikës 2, të nenit 4, të Rregullores dhe i lëshuar sipas pikës 1.1.1., të nenit 6, të Rregullores, për rastet kur i sëmuri nuk është trajtuar me raport mjekësor sipas pikës 1 dhe 2, të këtij neni, për periudhën 1-14 ditë të tij (raportit mjekësor) është i vlefshëm për pagesë nga punëdhënësi".

3. Pas pikës 1.1., të nenit 6, të Rregullores, shtohet pika 1.1.1., me këtë përmbajtje:
"1.1.1. Raporti elektronik mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë për sëmundje të përgjithshme për personin e punësuar që shtrohet në institucione shëndetësore me shtretër, lëshohet nga mjekët përgjegjës të institucionit për periudhën e shtrimit, por jo më shumë se 60 ditë nga data e shtrimit dhe për rastet kur i sëmuri është trajtuar me raport mjekësor sipas nenit 5 të Rregullores, është i vlefshëm për pagesë nga sigurimet shoqërore për të gjithë periudhën e pasqyruar në të, në të kundërt, nga dita e 15 e në vijim".

4. Pika 3, e nenit 7, të Rregullores, ndryshon si vijon:
"3. Dokumentacioni mjekësor që vërteton diagnozën dhe periudhën e trajtimit të qytetarit administrohet në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, e cila brenda 5 ditëve pune, shqyrton dokumentacionin mjekësor, verifikon periudhën e sigurimit për plotësimin e kushteve ligjore për të drejtën e përfitimit, plotëson, nënshkruan dhe vulos formularin tip për lejimin e lëshimit të raporteve me prapaveprim dhe e dërgon për miratim e nënshkrim në Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe kjo e fundit brenda 5 ditëve pune e rikthen në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për t'ia vënë në dispozicion kërkuesit.
Komisioni Mjekësor, bazuar në dokumentin miratues të lëshimit të raporteve mjekësore me prapaveprim, lëshon nëpërmjet sistemit e-Raporte raportet mjekësore për paaftësi të përkohshme në punë për të gjithë periudhën e trajtimit nga Institucioni Shëndetësor".

5. Pikat 5.1 dhe 5.2, të nenit 11, të Rregullores, ndryshojnë si vijon:
"5.1. Nëna trajtohet me raport mjekësor për leje lindje (leje paslindje dhe kujdes ndaj fëmijës) pas regjistrimit të fëmijës në zyrën e gjendjes civile. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore brenda 5 ditëve pune shqyrton dokumentacionin mjekësor përkatës, të lëshuar nga institucioni i huaj shëndetësor që ka ndjekur nënën dhe/apo fëmijën, verifikon periudhën e sigurimit për plotësimin e kushteve ligjore për të drejtën e përfitimit, plotëson, nënshkruan dhe vulos formularin tip për lejimin e lëshimit të raporteve me prapaveprim dhe e dërgon për miratim e nënshkrim në Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe kjo e fundit brenda 5 ditëve pune e rikthen në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për t'ia vënë në dispozicion kërkueses.
Mjeku i familjes ku ka kartelën nëna ose fëmija, bazuar në dokumentin miratues të lëshimit të raporteve mjekësore me prapaveprim, lëshon nëpërmjet sistemit e-Raporte raportet mjekësore për barrëlindje.

5.2. Nëna trajtohet me raport mjekësor për leje lindje (leje paslindje dhe kujdes ndaj fëmijës) edhe për rastet e mos regjistrimit të fëmijës në zyrën e gjendjes civile. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, brenda 5 ditëve pune shqyrton dokumentacionin mjekësor përkatës, të lëshuar nga institucioni i huaj shëndetësor që ka ndjekur nënën dhe/apo fëmijën dhe aktin e lindjes, të përkthyer në gjuhën shqipe, të noterizuar e të legalizuar sipas legjislacionit në fuqi, verifikon periudhën e sigurimit për plotësimin e kushteve ligjore për të drejtën e përfitimit, plotëson, nënshkruan dhe vulos formularin tip për lejimin e lëshimit të raporteve me prapaveprim dhe e dërgon për miratim e nënshkrim në Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe kjo e fundit brenda 5 ditëve pune e rikthen në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për t'ia vënë në dispozicion kërkueses.
Mjeku i familjes ku ka kartelën nëna ose fëmija, bazuar në dokumentin miratues të lëshimit të raporteve mjekësore me prapaveprim, lëshon nëpërmjet sistemit e-Raporte raportet mjekësore për barrëlindje.".

6. Shtesat dhe ndryshimet në Rregulloren nr. 2666/1, datë 21.6.2022 / nr. 4360/1, datë 22.6.2022 "Për kriteret, rregullat dhe procedurat për lëshimin e raporteve mjekësore për paaftësi të përkohshme për punë, për barrëlindje dhe për aksidente në punë e sëmundje profesionale", fillojnë efektet e zbatimit më datë 01.01.2024.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Suzana HOXHA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Astrit HADO